

# TË DREJTAT E PERSONAVE LGBTIQ+ DHE INSTITUCIONET QË NDIHMOJNË NË SHTRIRJEN E TË DREJTAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT


E drejta e identitetit dhe privatësisë janë të drejtat tuaja të patjetërsueshme dhe detyra e sistemit mbështetës është të ofrojë ndihmë dhe të trajtojë sigurinë tuaj si qëllim parësor.

Të drejtat e personave LGBTIQ+ janë të mbrojtur me ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Askush nuk mund të kufizojë të drejtën tuaj për arsimim, punësim, kujdes shëndetësor dhe strehim, as t'ju detyrojë të flisni publikisht për orientimin tuaj seksual dhe identitetin gjinor.

## POLICIA

Raportoni dhunën, dhunën në familje, krimet e urrejtjes dhe/ose gjuhën e urrejtjes në polici.



### ÇFARË MUND TË BËJË POLICIA

- ✓ Paraqet njoftim në Prokurori për fillimin e procedimit penal. Fillon procedurë kundërvajtëse kundër shkelësit.
- ✓ Parashtron kërkesën për marrjen e masës urgjente mbrojtëse në gjykatë në rastet e dhunës në familje.

### ÇFARË MUND TË BËNI NËSE POLICIA NUK I MBRON TË DREJTAT TUAJA?

- ✓ Paraqisni një ankesë tek Avokati i Popullit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm dhe Standardeve të Policisë.
- ✓ Paraqisni ankesë në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm tek Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- ✓ Nëse policia abuzon me pozitën e saj gjatë raportimit, paraqisni kallëzim penal në Prokurori.

## PROKURORIA E MAQEDONISË SË VERIUT

Në Prokurori dorëzohen kallëzimet mbi dhunë, dhunë në familje, krim të urrejtjes dhe/ose gjuhë të urrejtjes dhe për mosveprim nga policia gjatë raportimit të një krimi ose ngacmimi gjatë kryerjes së shërbimit policor.



### ÇFARË MUND TË BËJË PROKURORIA?

- ✓ Të kryejë një hetim, të mbledhë prova dhe të ngrejë akuzë në gjykatë.

### ÇFARË TË BËNI NËSE PROKURORIA NUK MBRON TË DREJTAT TUAJA

- ✓ Nëse prokuroria vendos të mos kryejë hetim, rrëzon kallëzimin penal ose ndërprer procedurën, mund të bëni ankesë në Prokurorinë e Lartë Publike.

## KOMISIONERI PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

Kërkesa i paraqitet Komisionerit për diskriminimin në të gjitha sferat e jetës, ngacmim dhe/ose ngacmim seksual.




### ÇFARË MUND TË BËJË KOMISIONERI PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

- ✓ Të japë mendim për diskriminimin dhe të japë rekomandim që shkelësi duhet ta zbatojë brenda një afati të caktuar.
- ✓ Në rast se shkelësi nuk vepron sipas rekomandimit, Komisioni do t'i paraqesë kërkesë gjykatës kompetente për gjobëvënie për kundërvajtje.



## AVOKATI I POPULLIT

Avokatit të Popullit i dorëzohet një raport lidhur me **diskriminimin nga administrata shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe organet dhe organizatat e tjera që kanë kompetenca publike** (diskriminimi në çdo sferë të jetës, dhuna policore, shkeljet e të drejtave të njeriut nga institucionet).



### ÇFARË MUND TË BËJË AVOKATI I POPULLIT PËR TË PARANDALUAR DHE OFRUAR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI?

- ✓ Të japë rekomandim, mendim dhe cek mënyrën e anashkalimit të shkeljes.
- ✓ Të marrë iniciativë për fillimin e procedimit disiplinor ose kundërvajtës ndaj personit përgjegjës në institucionin që ka kryer shkeljen.
- ✓ Të paraqesë kërkesë tek prokurori publik për të përcaktuar përgjegjësinë penale të personit që ka kryer shkeljen.

## GJYKATA CIVILE

Në Gjykatën Civile paraqitet një kërkesë lidhur me **diskriminim në të gjitha sferat e jetës, dhunën në familje, ngacmimet, shkeljet e të drejtave të njeriut.**




### ÇFARË MUND TË BËJË GJYKATA CIVILE

- ✓ Të japë vendim në favor të viktimës dhe të japë kompensim për dëmin e pësuar.
- ✓ Në rast të dhunës në familje, gjykatë mund të shqiptojë masën e mbrojtjes emergjente - largimi i dhunuesit nga shtëpia dhe ndalimi i tij për t'iu afruar shtëpisë së viktimës dhe vendosja e një mase tjetër të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje..

### ÇFARË TË BËNI NËSE GJYKATA CIVILE NUK MBRON TË DREJTAT TUAJA?


- ✓ Në rast se nuk jeni të kënaqur me aktgjykimin e gjykatës, mund të paraqisni kërkesë në Gjykatën e Apelit
- ✓ Në rast se nuk merrni mbrojtje efektive brenda vendit, ju mund të apelononi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



## GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Ankesa bëhet vetëm pasi të keni shtuar të gjitha mjetet juridike që mund të zgjidhin situatën për të cilën ankoheni (duke përfshirë ngritjen e padisë në gjykatë, paraqitjen e ankesës, nëse lejohet, në gjykatën më të lartë dhe/ose paraqitjen e ankesës kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut.

**Detyra e gjykatës është të sigurojë që shtetet të respektojnë të drejtat dhe garancitë e dhëna nga organet për të Drejtat e Njeriut.**



## ORGANIZATAT CIVILE QË NDIHMOJNË KOMUNITETIN

Ata ju ndihmojnë, ju informojë dhe ju shoqërojnë në ushtrimin e të drejtave tuaja.

### Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

- ✓ Ofrimi i mbështetjes dhe këshillave të përgjithshme duke përfshirë këshilla ligjore, mbështetje gjatë raportimit të një incidenti dhe mbështetje gjatë gjatjes së punësimit.
- ✓ helkom@mhc.org.mk
- ✓ info@lgbti.mk
- ✓ https://mhc.org.mk/

### Koalicioni Margjinat

- ✓ Ofrimi i mbështetjes dhe këshillave të përgjithshme duke përfshirë këshilla ligjore, mbështetje gjatë raportimit të një incidenti dhe mbështetje psikosociale.
- ✓ koalicijaszpmz@gmail.com
- ✓ koalicioni.org.mk

Mund të gjeni një listë të organizatave civile në ueb-faqen: <https://you-are-heard.org/support/>

Nëse keni nevojë për ndihmë, dëshironi të raportoni diskriminim ose keni nevojë për më shumë informacion, vizitoni ueb-faqen

[you-are-heard.org](https://you-are-heard.org)

